

SHPËTIMI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA "IZOLIMI"

Ministri i Brendshëm, Zenun Pajaziti, tha se Suedia po përgatit një dokument për ta nxjerrë Kosovën nga izolimi.
Kriteret politike paraqesin një nga sfidat më të mëdha, ngase pesë vende të BE-së ende nuk e kanë njohtur Kosovën, përderisa për ato teknike institucionet kanë ndërmarrë masa për përbushjen e tyre

Presedanca e ardhshme suedeze e BE-së, përmes ministrit të Jashtëm, Karl Bildt, ka theksuar se një nga priorititetet do të jetë edhe çështja e liberalizimit të vizave për Ballkanin Perëndimor. Ndërkohë që përfaqësues të prezencës së misioneve diplomatike në Kosovë dhe institucioneve të vendit theksuan perspektivën e vendit në këtë proces. Ambasadorja çake në Kosovë, Janina Hrebickova, vendi i së cilës brenda disa ditësh do t'i dorëzojë Suedisë presidencën e radhës së BE-së, i ka dhënë mbështetje Kosovës për t'u përfshire në këtë proces. Kurse ministri i Brendshëm, Zenun Pajaziti,

Suedia, dokument PËR KOSOVËN



"Kërcënimet" e BE-së

Zyrtarë të BE-së, herë në mënyrë zyrtare e më shumë konfidenciale, kanë paralajmëruar Beogradin që të mos japë pasaporta qytetarëve të Kosovës, se ato nuk do të nijhen. Madje, disa nga vendet Perëndimore, sipas burimeve të konsultuara, kanë bërë të ditur se nuk do t'i lejojnë qytetarët e Kosovës të hyjnë në

të kushteve për heqjen e vizave nga ana e BE-së. "Një nga sfidat qëndron te mos njohtja e Kosovës nga disa vende të BE-së, që nuk janë shumë, por që paraqesin pengesë në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sidoqoftë, Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në procesin liberalizimit të vizave dhe për këtë ka hartuar një plan të bazuar në praktikat e vendeve fqinjë dhe në konsulta me faktorë ndërkombtarë. "Plani i veprimit për zbatimin e kriterive të

Kontributi i EULEX-it

Përfaqësuesi i EULEX-it në këtë konferencë, Domenik Orsini tha se EULEX-i nuk mund të kontribuojë direkt në procesin e liberalizimit të vizave, por, sipas tij, EULEX-i do të kontribuojë në fushën e sundimit të ligjit. "Nëse kërkohet mbështetje më konkrete për këtë proces, EULEX-i në stafin e tij ka shumë ekspertë të vendeve që kanë kaluar nëpër këtë proces dhe ata mund të jepin një kontribut në këtë aspekt", tha Orsini.

të integruar të kufijve, ku një nga sfidat paraqet pjesa veriore e vendit, tha se rruga e vetme, të cilën duhet ndjekur BE-ja, është të përpilojë një agjendë të quartë që do ta përfshinte Kosovën në procesin e liberalizimit. Komisioni Evropian i ka ofruar Malit të Zi, Maqedonisë dhë Serbisë perspektivën e liberalizimit të vizave deri në fund të këtij viti, duke e lënë Shqipërinë dhe Bosnjë e Hercegovinën të presin rastin tjetër



Bildt, Kosova TË KETË KUJDES ME EKONOMINË

Shëfi i diplomacisë suedeze, Karl Bildt, pasi shprehu shqetësimin për gjendjen e zhvillimit ekonomik të Kosovës, porositi autoritetet kosovare që të merren më seriozish me këtë çështje. Gjatë prezantimit të prioritetave të presidencës suedeze me BE-në nga 1 korriku, Bildt theksoi: "Kjo ishte detyrë shumë e rëndë që në fillim, ndërsa tani jemi në krizë ekonomike të paprecendecë gjë që e bën sfidën e Kosovës edhe më serioze". Megjithatë, ai tha se nuk parashesh ndonjë komplikim shështë në aktivitetet rrithë Kosovës për shkak të mosnjabies së pavarrë-

eve diplomatike në Kosovë dhe institucioneve të vendit theksuan perspektivën e vendit në këtë proces. Ambasadorja çake në Kosovë, Janina Hrebickova, vendi i së cilës brenda disa ditësh do t'i dorëzojë Suedisë presidencën e radhës së BE-së, i ka dhënë mbështetje Kosovës për t'u përfshirë në këtë proces. Kurse ministri i Brendshëm, Zenun Pajaziti, tha se Suedia po përgatit një dokument për ta nxjerrë Kosovës nga izolimi. Kriteret politike paraqesin një nga sfidat më të mëdha, ngase pesë vende të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën përderisa për ato teknike institucionet kanë ndërmarrë të gjitha masat përmëbushjen e tyre. Këto janë një nga çështjet kryesore që u thanë në konferencën e organizuar nga European Stability Initiative. Ambasadorja çake, Hrebickova, tha se është çështje e Qeverisë së Kosovës të angazhohet në plotësimin e kushteve për liberalizimin e vizave, ndërsa dha mbështetje për përfshirjen e Kosovës në këtë proces.

"BE-ja dhe Presidenca Çeke në shumë raste e kanë thënë se Kosova nuk duhet të lihet mbrapa kur fqinjët e saj ecin përparrë. Mund t'ju siguroj se BE-ja është përcaktuar që

zyrta e BE-së, njerëz me mënyrë zyrtare e më shumë konfidenciale, kanë paralajmëruar Beogradin që të mos jep pasaporta qytetarëve të Kosovës, se ato nuk do të njihen. Madje, disa nga vendet Perëndimore, sipas burimeve të konsultuara, kanë bërë të ditur se nuk do t'i lejojnë qytetarët e Kosovës të hyjnë në vendet e tyre me pasaporta të tjera.

të mos lejojë të ndodhë ky izolim për Kosovën jo vetëm për hir të Kosovës, por për hir të stabilitetit dhe të sigurisë në rajon, gjithashu jo vetëm për hir të emigracionit, por edhe për hir të vlerave dhe të sigurisë së BE-së", tha Hrebickova.

Paralajmërimi i Pajazitit

Ministri i Brendshëm, Pajaziti, beson se Suedia, e cila do të marre presidencën e radhës së BE-së, do të propozojë një formë se si Kosova de faktë të përfshihet në këtë proces duke evitar kundërshtinë evenuale të vendeve që nuk e kanë njohur. Duke folur për angazhimet për këtë proces, ministri Pajaziti tha se Qeveria e ka miratuar një dokument për plotësimin e njëanshëm

shumë, por që paraqesin pengesë në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sidoqoftë, Qeveria e Kosovës është e përkushtruar në procesin liberalizimit të vizave dhe për këtë ka hartuar një plan të bazuar në praktikat e vendeve fqinjë dhe në konsulta me faktorë ndërkombëtarë. "Plani i veprimet për zbatimin e kriterieve të kërkua të miratohet diku në çerekun e tretë të këtij viti. Me këtë proces do të merren Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave", tha ministri Pajaziti. Ai tha se nuk është vetëm çështja e pasaportave biometrike, të cilat pritet të lëshohen nga viti i ardhshëm, që mundëson liberalizimin e vizave, por një sërë kriteresh teknike ku Kosova nuk është larg vendeve të rajonit. "Kosova ka avancuar në këtë drejtim. Me gjithë vështirësive që i kemi në veri, Kosova ka adaptuar legjislacionin, kemi strategji, plan veprimi, kemi një bord të instaluar dhe kemi rezultate pozitive", tha Pajaziti.

Një nga kriteret teknike dhe kërkesë e vazhdueshme e disa vendeve është çështja e riadhësimit. Gjatë Rëtij viti pritet të realizohen tri marrëveshje me vendet Perëndimore përi riadhësim, por edhe të hapet rrugë e re përmigrim legal. Po ashtu, një nga kriteret është edhe menaxhimi i kufijve, mbrojtja e të dhënave, dokumentet dhe kualiteti i tyre, lufta antikorrupsion, reformat për sa i përket fushës së sundimit të ligjit etj.

Knaus, s'e ndalim dot Serbinë t'u japë kosovarëve pasaporta

Verena Knaus, nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet, përvëç shtrimit të çështjes së menaxhimit

tha se rruga e vetme, të cilën duhet ndjekur BE-ja, është të përpilojë një agjendë të qartë që do ta përfshinte Kosovën në procesin e liberalizimit. Komisioni Evropian i ka ofruar Malit të Zi, Maqedonisë dhë Serbisë perspektivën e liberalizimit të vizave deri në fund të këtij viti, duke e lënë Shqipërinë dhe Bosnjë e Hercegovinën të presin rastin tjetër për vitin e ardhshëm. Serbia thotë se do t'u lëshojë pasaporta qytetarëve të Kosovës. Ndërkohë që nuk ka ndonjë qëndrim unik të vendeve të BE-së lidhur me këtë çështje ku vërehet një ndarje e theksuar. Znj. Knaus tha se aktualisht është e pamundshme t'i ndalojë Serbisë që t'i jepë pasaporta për kosovarët, për shkak që pesë vende nuk e kanë njohur pavarësinë. "Kjo është një situatë shumë e ndërlikuar, sepse Komisioni Evropian nuk ka një qëndrim unik të arrihet përmes një shtetit të Kosovës, për shkak të mosnjohjes së pavarësise nga 5 shtete. Disa vende evropiane thonë se shtetasit e Kosovës janë shtetas të Serbisë, disa të tjera kanë frikë se dokumentet të mos identifikohen dhe nuk do të mund të ketë mbikëqyrje të mjaftueshme mbi procesin. Kështu që ende nuk ka një qëndrim të përbashkët për Kosovën", tha ajo. Ministri i Jashtëm serb, Vuk Jeremiq, gjatë ditës së djeshme përmes njësies së diplomacisë së Kosovës tha se do t'u jepë pasaportat biometrike edhe qytetarëve të Kosovës, duke e konsideruar këtë si çështje teknike. Të gjithë qytetarët e Serbisë, në pajtim me Koshtetutën dhe ligjin, duhet të kenë rast që t'i marrin pasaportat e reja, nëse i kërkojnë, megjithëse për të gjithë qytetarët e Kosovës, që do të aplikojnë përmëbushjen e pasaportës, do të ndërmarrën "masa të posaçme për verifikimin e sigurisë", ngase atje edhe "ekzistojnë rrethana të ndryshme të sigurisë", theksoi Jeremiq.

I.KRASNIQI

çështje. Gjatë prezantimit të prioriteteve të presidencës suedeze me BE-në nga 1 korriku, Bildt theksoi: "Kjo ishte detyrë shumë e rëndë që në fillim, ndërsa tanë jemi në kritë ekonomike të paprecendecë gjë që e bën sfidën e Kosovës edhe më serioze". Megjithatë, ai tha se nuk parashesh ndonjë komplikim shpeshtë në aktivitetet rreth Kosovës për shkak të mosnjohjes së pavarësise nga 5 vende të BE-së. Ai e vlerësoi të rëndësishëm faktin se EULEX-i po përkrahet nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Shefi për politik të Jashtme i Suedisë, Karl Bildt, pret që gjatë presidencës së vendit të tij të BE-së do të arrihet progres në liberalizimin e vizave për Ballkanin Perëndimor. Ai në Bruksel gjatë prezantimin të planit të presidencës së BE-së gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, tha se Suedia do të angazhohet në zgjerimin e BE-së në Kroaci dhe në Turqi, por edhe në çështjen e liberalizimit të vizave për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Bildt tha se Suedia do të mbetet e përkushtuar në bisedime për anëtarësimin e Kroacisë dhe Turqisë, edhe pse në të dyja vendet ka pengesa të caktuara. "Është kërkesa e Mali i Zi përmarrjen e statusit të kandidatit në Komisionin Evropian, në Shqipëri të dielën mbahen zgjedhjet dhe shpresojmë se pas kësaj do të kemi aplikimet e tyre", tha Bildt. Ai tha se shpreson se do të arrihet deri te progresi në procesin e integrimeve evropiane me Serbinë dhe BH-në, duke vlerësuar se çështja e liberalizimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe në BE do të janë çështje kryesore. Se me çfarë ritmi do të arrinjë progres në çështjet teknike të lidhura me liberalizimin e vizave, kjo varet nga ata", tha Bildt duke nënizuar se shumë shpejt pritet të marrë rekomandimin e KE-së.

RREZIKU NGA IZOLIMI, EDHE NË NIVEL RAJONAL

Mospërshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave mund të lëri të izoluar vendin, aq më shumë edhe në lëvizjen e lirë te vendet fqinjë, si Maqedonia, e cila me përfshirjen e saj në këtë proces do të jetë e detyruar të aplikojë viza. Ndërëse ende nuk ka paralajmërimi tilla, ministri i Punëve të Brendshme, Pajaziti, ka ngritur këtë çështje gjatë takimeve në Bruksel. "Kosovë nuk e pengon progresi i vendeve fqinjë. Ne kemi paraqitur këtë çështje në Bruksel dhe kërkessën që të përfshilhem i në këtë proces që të mos mbetemi të izoluar, sidomos kur në të do të përfshihen vendet e rajonit. Ne ende nuk kemi një paralajmërim, por kemi paragjykuar për këto shqetësime. Nuk besojmë se BE-ja do t'i lejojë Kosovën e izoluar. Perspektiva është ajo që ka cekur ambasadori Italian, por duhet të përballemi me përgjegësitë tona dhe sfidat tona", tha Pajaziti.